



Date 31 JANAR 2025

DËSHMI PËR MIRATIMIN E KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS

(Punëtoreve te Mendjes me Edukimin e Larte Universitar me Titullin përkatës Inxhinier te Profesionit te zgjedhur prej tyre) SI EDHE SPECIALISTEVE DHE NENSPECIALISTEVE PLOTESUES (Punëtorët e Fuqisë se Krahut)”

Ne te drejtën civile te Aktit Themeltar te Shteti qe është Kushtetuta e RSH-se, përkatësisht nenit 18 pika 1 dhe 2, nenit 49, pika 1 dhe 2. Ne vijim tërësisht ne zbatim te te Drejtave Civile Globale te Individëve qe punojnë, ne referim te KONVENTAVE TE RATIFIKUARA NGA RSH-se, si edhe Veçanërisht ne; Ligjin nr. 7850, date 29/07/1994 Kodit Civil te RSH-se i përditësuar, përkatësisht ne nenit 79, 661, 663, 664. Ligjin nr. 7961, date 12.7.1995 Kodi i Punës te RSH-se i ndryshuar, përkatësisht germa d), Kontrata Kolektive e Punës, pika 1. Neni 11, pika 1,2,3 e neni 159 Kontrata Kolektive e Punës, ne vijim tërësisht; Ligjin nr. 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative RSH-se, germa a),b) pika 1, germa a) pika 2, neni 2 Fusha e Zbatimit;

Në mbështetje dhe në zbatim të Aktit të Krijimit të datës 12 MARS 2023 “Për Krijimin e Urdhrit të Inxhinierive në Republikën e Shqipërisë”, te Statutit te Entit Publik Kombëtar.

Te projekt-vendimit te “Kryesisë se Entit Kombëtar”, qe ka propozuar Për miratim/Për Dëshmim “Aktin e Krijimit te Kontratës Kolektive te Punës” ne Asamblenë Kombëtare.

Palët e përfshira në kontratë: Enti Publik Kombëtar Urdhri i Inxhinierive ne Republikën e Shqiperise si përfaqësuesi i Punonjësve dhe Urdhërimi i Veçantë i çdo profesioni si përfaqësues i Punëdhënësit.

Ky Akt Krijimi është Detyrim i Ligjor.

Për te Drejtat dhe Detyrimet te lidhura me “Marrëdhënien e Punës”

Kodi i Punës (nr7961,date 12.7.1995 i ndryshuar)	Ligji - PPRR (nr 10171,date 22.10.2009 i ndryshuar)	Kodi Proc.Adm (nr 44/2015)
Germa d), Kontrata Kolektive e Punës, pika 1. Neni 11 pika 1,2,3 e neni 159 Kontrata Kolektive e Punës,	Germa a),b) Neni 2 Qëllimi i Ligjit	Germa a),b) pika 1, Germa a) pika 2, Neni 2 Fusha e Zbatimit

ne referim edhe ne zbatim te se drejtës civile Kodi Civil, neni 663 *Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë:*

***pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin ¹,
shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi,
objekti që formon lëndën e kontratës,
forma e saj e kërkuar nga ligji. (kontrata kolektive e punës)***

Ne këto kushte Enti Publik Kombëtar Urdhri i Inxhinierive ne RSH, ne referim te nenit 661 *Kontrata është me detyrim të njëanshëm, kur njëra palë merr përsipër detyrime ¹ ndaj palës tjetër pa patur kjo e fundit ndonjë detyrim ndaj saj...*

² Termi "***që rrjedh nga natyra e marrëveshjes***" nënkupton se një detyrim ose e drejtë e caktuar lind në mënyrë të natyrshme ***nga karakteri, qëllimi, dhe përmbajtja e një marrëveshjeje***. Kontrata Kolektive e Punës ndonëse nuk nënshkruhet nga individët, Punëdhënësi/Punëmarrës, është e pritshme, si edhe detyruese ne referim te kodeve, qe marrëdhënia e punës te jete e normalizuar/formalizuar nëpërmjet KIP-ës, por e vlerësuar dhe i siguruar nga KKP-ës, si edhe nga Kontrata Individuale e Punës. Këto janë detyrime që rrjedhin natyrshëm nga natyra e marrëveshjes, sepse janë pjesë e kuptuar e asaj marrëdhënie, si edhe minimalisht te vlerësuar prej bazës qe është Kontrata Kolektive e Punës.

Marrëdhënia e Punës është një proces formal që mbështetet në kontratë dhe ligjin specifik të punës, e cila synon të mbrojnë të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve.

Marrëdhënia e Punës krijohet nëpërmjet Veprimit Juridik ndërmjet një punonjësi dhe një punëdhënësi, qe rregullohet nga një kontratë pune individuale. Në këtë marrëdhënie, punonjësi detyrohet të kryejë një shërbime (pune) të caktuar në favor të punëdhënësit, ndërsa punëdhënësi ka detyrimin t'i ofrojë punonjësit pagën dhe kushtet e tjera të punës të përcaktuara, të rregulluara me ligj ne vijim Kodi i Punës, Kontrata Kolektive e Punës, Kontrata Individuale me specifikimet e punës.

Palë në këtë Marrëveshje “Kontrata Kolektive e Punës” janë;

❖ ***Punëmarrësit në Profesionet e Rregulluara mund të përfaqësohen nga një gamë e gjerë aktorësh, përfshirë organizatat Entet Profesionale, Këshillat Profesionale dhe Autoritetet Publike. Këto entitete sigurojnë që të drejtat dhe interesat e punëmarrësve të mbrohen dhe që ata të kenë përfaqësim adekuat në negociatat për kushtet e punës dhe standardet profesionale.***

❖ ***Në Profesionet e Rregulluara, Punëdhënësit mund të përfaqësohen nga një sërë entitetesh që janë të përshtatshme për natyrën dhe kërkesat specifike teknike të këtyre profesioneve. Profesionet e Rregulluara janë ato që kanë standarde dhe kërkesa të veçanta ligjore për praktikimin e tyre me certifikime specifike.***

1) Enti Publik Kombëtar Urdhri i Inxhinierive ne Republikën e Shqiperise, përfaqëson interesat e përbashkëta te **Individëve/Punëtorëve/ Punëtorëve te Mendjes dhe Punëtorëve te Fuqisë se Krahut** dhe është *Autoriteti Kompetent përfaqësues i Punëmarrësit.*

Institucioni i URDHRI INXHINIERI’VE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, me qellim koordinimin dhe garantimin e vetë rregullimit të të drejtës së ushtrimit të profesioneve specifike, ka të drejtën dhe detyrimin për të menaxhuar zhvillimin e qëndrueshmërinë te;

a) **Inteligjencës Profesionale te Disiplinave te Inxhinierive** si edhe **te nen disiplinave**, por pa u kufizuar **tek specialistet dhe nën specialistet plotësues.**

- ✓ Mbështetur ne kapaciteti intelektual i njerëzve qe kryejnë shërbime profesionale, te cilët karakterizohen nga perceptimi, vetëdija dhe vullneti i tyre, mbështetur mbi kualifikimet e përkatëse te çdo profesionisti.
- ✓ Mbështetur ne inteligjencën e profesionistit me nivelin e larte te edukimit qe posedojnë aftësitë njohëse për të mësuar, për te formuar koncepte, për te kuptuar, për te aplikuar logjikën dhe arsye, duke përfshirë kapacitetin për të njohur modelet e kodit te vete rregullimit, si edhe qe kuptojnë idetë, planifikojnë, zgjidhin probleme, marrin vendime, mbajnë mend, si edhe qe të përdorin gjuhën për të komunikuar me qellim ushtrimin e profesionit te zgjedhur prej vete atyre.

2) Enti Publik Kombëtar, i çdo Urdhërimi te VECANTE i çdo profesioni, është institucioni ideal rregullator për te dhënë te "drejtën e ushtrimit te profesionit", ne referim te nr 10171, date 22.10.2009 i ndryshuar, dhe kane te drejtën dhe detyrimin për te përfaqësuar punëdhënësin, sipas objekti te veprimtarisë specifike te çdo profesioni.

Punëdhënësit në Profesionet e Rregulluara mund të përfaqësohen nga një kombinim i enteve profesionale, këshilltarëve ligjorë dhe organizatave të sektorëve të veçantë. Ky përfaqësim ndihmon për të siguruar që interesat e tyre të mbrohen dhe të respektohen standardet ligjore të fushës përkatëse te veprimtarisë se çdo profesioni te inxhinierive me vete.

Ne mungese te Urdhrit te Veçantë dhe deri ne krijimi e urdhrit profesional përkatës, këtë drejte dhe detyrë do te kryej, Departamenti Profesional përkatës si Këshillues Ligjor. Këshilli Profesional do te përfaqësoj interesat e punëdhënësve dhe profesionistëve brenda sektorit/departamentit, qe paraprakisht duhet te krijohet, grupi përfaqësues dhe ne vijim te funksionojë si departament brenda Urdhrit te Inxhinierive ne RSH-se, deri sa te mund te krijohet urdhri veçantë.

Deklarohet se: Kontrata Kolektive e Punës e Dëshmuar prej Anëtare te Urdhrit te Inxhinierive ne RSH-se, e nënshkruar prej Anëtarëve [*proces i përfunduar ne 26 Dhjetor 2024*] është shqyrtuar dhe miratuar nga institucioni i Asamblesë Kombëtare te Urdhrit te inxhinierive ne Republikën e Shqipërisë, i cili Dëshmojë Aktin e Krijimit te KKP-ës [*Dëshmuar me datën 26 Dhjetor 2024*].

Ky miratim bazohet në përputhjen te dispozitave të kontratës kolektive, me legjislacionin në fuqi dhe respektimin e të drejtave të punëmarrësve dhe detyrimeve të punëdhënësit.

Data e miratimit: [26 Dhjetor 2024]

Numri i Vendimit: [02-12-2024]

Lëshuar nga: [Urdhri i Inxhinierive ne RSH-se]

Përfaqësuesi i institucionit:

Emri dhe mbiemri: [Inxhinieri Hidroteknike EDUARD NALLBANI]

Pozicioni: [ne cilësinë e Sekretarit te Përgjithshëm te Entit Publik Kombëtar]

Firma dhe vula:

Shënime:

1. Kjo dëshmi vlen si dokument ligjor për njohjen dhe zbatimin e kontratës kolektive të punës.
2. Çdo ndryshim në kontratë duhet të miratohet nga organi përkatës.

